

## NJOFTIM

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, urdhrit nr. 454, datë 13.9.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, të ndryshuar, urdhrit nr. 571, datë 18.11.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”, Urdhrit nr. 81, datë 27.04.2026, “Për shpalljen e konkurrimit për pozicionet specialist i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Gramsh, Kukës Fier”, kandidatët që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme janë:

*1. Për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Gramsh*

*- Znj. Redjana Mesiti*

*2. Për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kukës*

*- Znj. Afërdita Cengu*

*3. Për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Fier*

*- Znj. Eriselda Banaj*

*- Znj. Etleva Hysaj*

Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 21.05.2026, ora 11:00, në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Rruga “Aleksandër Moisiu”, Tiranë.

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datën 28.05.2026, ora 11:00, në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Rruga “Aleksandër Moisiu”, Tiranë.